

E DREJTA PËR INFORMIM

Modeli i ri i Programit të Transparencës për NJVV-të, zhvillohet në Pogradec takimi konsultues

Bashkia Pogradec ishte mikpritëse e takimit të tretë konsultues për modelin e ri të Programit të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, një nismë e Zyrës së Komisionerit. Takimi u zhvillua pas atyre të mbajtur në Lezhë dhe Shijak, në kuadër të projektit “Mbështetje për Zyrën e Komisionerit”, me asistencën teknike të projektit Bashki të Forta, Helvetas, që zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Aktivitetin e përshëndeti Kryetarja e Këshillit Bashkiak Pogradec, znj. Manjola Kamolli, e cila vlerësoi pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga administratat dhe këshillat bashkiakë të Korçës, Kukësit, Dibrës, Shijakut, Vlorës, Fierit, Maliqit, Tepelenës, Mallakastrës, Elbasanit dhe Mirditës. Në fjalën e tij, Komisioneri Dervishi theksoi, se “E drejta e informimit nuk është vetëm një ligj, është kulturë. Kultura e transparencës ndikon në ndriçimin e skutave të errëta të administratës”. Ndërsa, Kryetari i Bashkisë Pogradec, z. Ilir Xhakolli, duke falënderuar Zyrën e Komisionerit për përzgjedhjen e Pogradecit si mikpritës të këtij takimi, “e cilësoi si mjaft të rëndësishme këtë nismë që ndihmon administratat vendore të forcojnë standardet e transparencës dhe komunikimin me qytetarët”.



Në këtë aktivitet, z. Fatlum Nurja, ekspert i projektit “Bashki të Forta”, vuri në dukje angazhimin për mbështetjen e bashkive në hartimin dhe zbatimin e modelit të ri të Programit të Transparencës, ndërsa z. Sotiraq Hroni, drejtor ekzekutiv i IDM, theksoi, se “transparenca është parakusht për mirëqeverisjen dhe Programi i Transparencës është instrumenti që e vendos atë në shina konkrete”.

Nga Zyra e Komisionerit, znj. Emerlinda Pema, Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Programit të Transparencës, prezantoi për të pranishmit risitë dhe përmirësimet në Programin e Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, ndërsa iu përgjigj edhe interesit, pyetjeve dhe komenteve të pjesëmarrësve.

Komisioneri Dervishi në Sesionin Plenar të Konventës Kombëtare për Integrimin European

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, mori pjesë në Sesionin Plenar të Konventës Kombëtare për Integrimin European, organizuar nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA). Takimi trajtoi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në rrugën e Shqipërisë drejt BE dhe mblodhi aktorë nga institucione publike, shoqëria civile, academia dhe media për të diskutuar progresin dhe sfidat e reformave të Kapitullit 23 dhe standardeve europiane.

Në panelin hapës të këtij sesiioni, Komisioneri Dervishi theksoi se anëtarësimi në BE mbetet një objektiv strategjik kombëtar dhe se Zyrës së Komisionerit i takon një rol i rëndësishëm në të gjitha fazat e procesit. Ai vuri në dukje se ligji i ri nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” shënon një hap të madh në përmbushjen e një prej 14 piketave të Grupkapitullit të parë “Themelorët”. Dervishi solli në vëmendje edhe Raportin e fundit të Komisionit Evropian, i cili vlerëson progresin e vendit në këtë fushë, por nënvizon gjithashtu nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zbatimin praktik të ligjit. Komisioneri theksoi gjithashtu rëndësinë e partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile për të nxitur transparencën, pjesëmarrjen qytetare dhe mbrojtjen e të drejtave në përgjithësi, duke vlerësuar bashkëpunimin me EMA, por edhe me Avokatin e Popullit dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive.




Gjithashtu në kuadër të këtij aktiviteti, Drejtorja e Kabinetit të Zyrës së Komisionerit, znj. Besa Velaj, mori pjesë në Panelin 3: “Liria, Privatësia dhe Llogaridhënia”, ku trajtoi sfidat në zbatimin e kuadrit të ri ligjor, rolin e transparencës dhe llogaridhënies në forcimin e besimit publik, si dhe përfshirjen e medias dhe shoqërisë civile në promovimin e standardeve europiane. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet, diskutuan mbi problematikat në kuadër të transparencës.



Mbledhjet Komiteti i Planifikimit për Konferencën e ICIC 2026

Komiteti i Planifikimit të Konferencës së XVII Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) zhvilloi mbledhjen e tij të parë online për nisjen e përgatitjeve në aspektin përmbajtësor dhe logjistik të edicionit të vitit 2026 të Konferencës.

Nën drejtimin e Zyrës së Komisionerit, në cilësinë e Sekretariatit të ICIC, në këtë Komitet për herë të parë morën pjesë përveç përfaqësues nga institucione homologe/anëtare, edhe përfaqësues të aktorëve të tjerë të rëndësishëm, si organizata ndërkombëtare (UNESCO, OECD) dhe shoqërisë civile me rol aktiv në rrjetin e ICIC. Zgjerimi i përfaqësimit në këtë Komitet edhe me grupe interesi, është propozuar nga Zyra e Komisionerit dhe mori mbështetjen nga Komiteti Ekzekutiv ICIC, për ta bërë atë sa më gjithëpërfshirës.



7. GREEN AND INCLUSIVE CONFERENCE COMMITMENT

The conference will be designed as a green and inclusive event, integrating:

- Environmentally sustainable practices
- Accessibility for persons with disabilities
- Gender and geographical inclusivity



Tema e propozuar nga organizatorët e edicionit të vitit 2026 është “Integriteti i Informacionit në Epokën Digjitale”. Pjesëmarrësit diskutuan mbi formatin e Konferencës, strukturën tematike, pjesëmarrjen dhe logjistikën. U prezantuan elementët kryesorë të konceptit të Konferencës, përfshirë objektivat, rezultatet e pritshme dhe zhvillimin e aktiviteteve paralele gjatë periudhës së zhvillimit të saj, duke përfshirë aktivitete me të rinj dhe të tjera që lidhen edhe me inovacionin digjital.

Ndryshe nga edicionet e kaluara, Konferenca e ICIC e vitit 2026 do të mbahet në fund të muajit shtator, për të kombinuar zhvillimin e saj me kremtimin e 28 Shtatorit – Ditës Ndërkombëtare të Drejtës për Informim (IDUAI). Takimi i radhës i Komitetit të Planifikimit është parashikuar të mbahet në fund të janarit 2026, ku pritet të diskutohen në mënyrë më të detajuar programi dhe përcaktimi i datave të konferencës, ashtu si edhe përgatitjet logjistike.

Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2025, ka dhënë Vendimin [nr. 41, datë 27.11.2025](#), në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Sipas tij, në zbatim të detyrave të lëna nga rezoluta e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale për vitin 2024”, si dhe bazuar në Planin e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive 2025, ka kryer monitorimin e transparencës proaktive në faqen zyrtare të autoritetit publik “Porti Detar Shëngjin Sh.A.” (në vijim “autoriteti publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), parashikohet se: “Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publikpa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”. Në pikën 3 të nenit 4 të LDI përcaktohet se: “Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik”. Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike...”. Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin e Transparencës së Rishikuar me Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar”, i ndryshuar (në vijim “Urdhri nr. 187/2020”). Bazuar në sa më sipër, Zyra e Komisionerit monitoroi programin e transparencës në faqen <https://www.portidetarshengjin.al/programiitransparences.html> të autoritetit publik, në përfundim të të cilit rezultoi se autoriteti publik nuk ka përmbytur detyrimin ligjor bazuar në nenin 7 të LDI, për të përgatitur në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tij në internet kategoritë e informacionit sipas Urdhrit nr. 187/2020.

Konkretisht, nga monitorimi i kryer rezultoi se në faqen zyrtare të autoritetit publik gjendet i publikuar Programi institucional i Transparencës, por nuk është bërë publik informacioni në të gjitha kategoritë. Referuar konstatimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit me urdhrin nr. 197, datë 30.09.2025, “Për kryerjen e hetimit administrativ”, nisi këtë proces dhe më datë 14.10.2025 grupi i punës u paraqit pranë autoritetit publik. Pas verifikimit të fakteve dhe dokumentacionit, u mbajt procesverbali i hetimit administrativ, nga i cili rezultoi se autoriteti publik nuk ka përmbytur detyrimin për vënien në dispozicion dhe përditësimin e të gjitha kategorive të informacionit, që bëhen publike pa kërkesë, në Programin institucional të Transparencës. Autoritetit publik iu la afat deri më datë 31.10.2025, për të përmbytur detyrimet ligjore. Pas përfundimit të këtij afati, është monitoruar faqja zyrtare e autoritetit publik dhe është konstatuar se nuk janë përditësuar me informacion dhe dokumentacion të gjitha kategoritë e Programit të Transparencës.

Veçanërisht, konstatohet mungesa e të dhënave në rubrikën “Rreth autoritetit” dhe në pjesën më të madhe të kategorive në rubrikat e tjera nuk ka asnjë dokument apo informacion të publikuar. Autoriteti publik ka publikuar të dhënat e koordinаторit për të drejtën e informimit në programin e transparencës. Në këto kushte, me qëllim ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar të personit përgjegjës për përmbyturjen e detyrimeve ligjore lidhur me publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore. Nëpërmjet komunikimit elektronik, autoriteti publik njoftoi se po punojnë ende, edhe pse jashtë afatit. Seanca dëgjimore e parashikuar të zhvillohej më datë 14.11.2025, nuk u realizua pasi titullari i autoritetit publik nuk u paraqit në këtë seancë. Sa më sipër, Zyra e Komisionerit ka ri-monitoruar programin e transparencës në faqen zyrtare të autoritetit publik dhe deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, rezultoi se nuk ka publikuar/përditësuar të gjitha kategoritë e informacionit të programit institucional të transparencës sipas parashikimeve të LDI.

u vijon në fq. 5

Referuar pikës 1 të nenit 19 të LDI përgjegjësia për vënien në zbatim dhe përditësimin e Programit institucional të Transparencës rezulton e titullarit të autoritetit publik. E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi i Transparencës përfaqëson një nga instrumentet kryesore të promovimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut, për rrjedhojë çdo autoritet publik është i detyruar ligjërisht për vënien në zbatim dhe përditësimin me informacion të tij.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: “Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligjipassjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”. Pika 1 e nenit 19 të LDI, parashikon se: “Titullari i autoritetit publikmban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje administrative të parashikuara në shkronjën

ç/1 të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”. Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për përditësimin e Programit të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 187/2020, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me gërmën ç/1), të pikës 2 të nenit 18 të LDI. Duke marrë parasysh rrethanat e rastit, faktin që personi përgjegjës nuk është përsëritës në shkeljen e detyrimeve ligjore të sipërpërmendura dhe gjithashtu bazuar në parimin e proporcionalitetit, masa e dënimit me gjobë vlerësohet të jetë në kufirin minimal.

Për këto arsye, Komisioneri vendosi, që: a) autoriteti publik Porti Detar Shëngjin Sh.a., në zbatim të parashikimeve të LDI dhe sipas urdhrit nr. 187/2020, të përditësojë Programin e Transparencës brenda datës 12.12.2025; b) dënimi e titullarit të autoritetit publik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Gjithashtu, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2025, ka dalë edhe me vendimet e mëposhtme në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Vendim nr . 39, datë 20.11.2025, Për zbatimin e masave administrative për koordinatorin e të drejtës për informim të autoritetit publik Bashkia Cërrik

Vendim nr . 40, datë 27.11.2025, Për zbatimin e masave administrative për autoritetin publik Korporata Elektroenergjitike Shqiptare



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:

